



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:104346
Datë: 27.05.2024
Numri i dokumentit: 05736657

Ac.nr.3857/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, kolegji në përbërje nga gjyqtari Arsim Hamzaj - kryetar i kolegjit, Besnik Bislimaj e Besnik Feka - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a (KEK), Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a. (KEDS), të cilën sipas autorizimit e përfaqëson J.M- jurist i diplomuar nga ,,,, kundër të paditurit A.A nga ,,,, të cilin me autorizim e përfaqëson av.F.M nga ,,,, i caktuar nga Zyra Rajonale për ndihmë juridike falas në Gjilan, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës së paditëses, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - departamenti i përgjithshëm, C.nr.543/17, të datës 25.01.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **23.05.2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditëses Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a (KEK) Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a. (KEDS) me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - departamenti i përgjithshëm, C.nr.543/17, i datës 25.01.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar, C.nr.543/17, të datës 25.01.2021, në pikën I të dispozitivit e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) e paraqitur ndaj të paditurit A.A nga ,,,, me të cilën ka kërkuar që i padituri të obligohet t’ia kompensojë dëmin e shkaktuar material në shumë prej 149.64€, edhe atë me kamatë ligjore duke filluar prej ditës së ushtrimit të padisë e gjeri në pagesën definitive në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Në pikën II të dispozitivit e ka obliguar paditësen që të paditurit t’ia

paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 100,00€, krejt këtë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, pala paditëse në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar të njëjtin për shkak të *shkeljeve qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe aplikimit të gabuar të dispozitave ligjore*, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën e paditëses, të ndryshohet vendimi C.Nr.543/2017 i datës 25.01.2021, të aprovohet padia dhe kërkesëpadia e paditëses dhe të detyrohet i padituri që për dëmin e shkaktuar të ia paguaj paditëses shumën në lartësi prej 149.64 euro dhe atë me kamatë ligjore prej datës së ushtrimit të padisë e gjerë në pagesën definitive si dhe shpenzimet në emër të procedurës kontestimore apo lënda ti kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosije.

E paditura, përmes të autorizuarit të saj ka paraqitur përgjigje në ankesën e paditëses me propozim që gjykata e shkallës së dytë ankesën e paditëses ta refuzoj si të pabazuar ndërsa aktgjykimin e shkallës së parë ta vërtetoj.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- *Ankesa e paditëses është e pathemeltë.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me datën 02.08.2017, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi, kundër të paditurës, për shkak të kompensimit të dëmit material, me arsyet sikurse në padi.

Duke vepruar sipas padisë së paditësit, gjykata e shkallës së parë ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor dhe pas administrimit të provave dhe të gjitha shkresave të lëndës ka marrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.543/17, të datës 25.01.2021, me përmbajtje sikurse në dispozitivin e tij.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë pas analizimit dhe shtjellimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, e ka refuzuar kërkesë padinë e paditësit si të pabazuar ngase në bazë të provave të administruara gjykata nuk ka vërtetuar faktin se nga cila datë është shkaktuar dëmi material nga i padituri, po ashtu në bazë të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës e që në rastin konkret nuk kemi ndonjë ekspertizë nga eksperti përkatës për të vërtetuar dëmin e shkaktuar nga i padituri, në rastin konkret kemi kërkesën e paditëses se i padituri prej datës së pavërtetuar e deri më datën 02.02.2012, në shtëpinë e tij me qëllim që ti sjell pasuri të kundërligjshme ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar duke keqpërdorur njehësorin elektrik me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror, ku në këtë mënyrë ka pamundësuar regjistrimin e energjisë elektrike të shpenzuar, andaj nga këto veprime e ka dëmtuar paditësin në vlerën e lartcekur, andaj pasi që nuk kemi të vërtetuar dëmin, gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim se një kërkesë e tillë duhet të refuzohet. Sa i përket pretendimeve të autorizuarit të të paditurit se në rastin konkret kemi parashkrim të

kërkesës, një pretendim i tillë nuk qëndron ngase neni 377 i LMD së vjetër që ka të bëjë me kërkesën e shpërblimit të dëmit të shkaktuar me vepër penale parasheh se *“Kur dëmi është shkaktuar nga vepra penale dhe për ndjekjen penale është parashkruar një afat më i gjatë parashkrimi, kërkesa për shpërblimin e dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale”*, andaj në rastin konkret pasi që kemi të bëjmë me veprën penale vjedhje nga neni 252 par.1 i Kodit të Përkohshëm Penal i Kosovës parasheh se *“Kushdo që tjetrit ia merr pasurinë e luajtshme me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër dënohet me gjobë ose me burgim deri në tri vjet”*, duhet të kalojë dyfishi i kësaj vepre penale tri vite plus tri vite të tjera dhe në këtë rast dëmi është shkaktuar më datën 02.02.2012, ndërsa paditësja padinë e ka paraqitur më datë 02.07.2017 çka do të thotë se paditësja në afatin e paraparë ligjorë e ka paraqitur padinë. Gjithashtu duke u bazuar në nenin 319 pika 1 dhe 2 të LPK-ës, ka paraparë që *“secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*, kurse neni 322.1 ka paraparë *“në qoftë se gjykata në bazë të provave të marrura (neni 8 i këtij ligji) nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke aplikuar rregullat mbi barrën e provës”*, ndërsa neni 322.2 ka paraparë *“pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj po që se ligji nuk parasheh diçka tjetër”*, gjykata e shkallës së parë ka vendosur që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses t’ a refuzoj si të pabazuar, ku provat e administruara nuk kanë vërtetuar themelësinë e kërkesëpadsisë, andaj mbi këto baza gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK.

Gjykata e shkallës së parë i ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadsisë së paditësit, e në lidhshmëri me këtë e ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Tutje gjykata i ka arsyetuar të gjitha rrethanat me peshë përcaktuese duke filluar nga përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit, pastaj rrethanat që lidhen me kategorinë e dëmit dhe rrjedhimisht përfundimin për vëllimin e kërkesës së aprovuar.

Gjykata e Apelit nuk është lëshuar në vlerësimin e pretendimeve ankimore të palës se paditur lidhur me gjendjen faktike të konstatuara nga gjykata e shkallës së parë, për shkak se me dispozitën e nenit 491 paragrafi 1, i LPK-së, përcaktohet se: *“Aktgjykimi ose aktvendimi me të cilin përfundohet procedura e zgjidhjes se kontestit me vlerë të vogël mund të goditet me ankesë vetëm për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave mbi procedurën kontestimore dhe për shkak të zbatimit të gabuara të se drejtës materiale”*. Në kontekstin e dispozitës së- cituar nuk janë vlerësuar pretendimet ankimore për gjendjen faktike, por e njëjta është pranuar siç e ka

konstatuara gjykata e shkallës së parë dhe mbi bazën e konstatimeve që ka bërë ajo gjykatë është vlerësuar nëse aktgjykimi është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës apo të së drejtës materiale. Në këtë rast gjykata ankimore ka gjetur se aktgjykimi i atakuara nuk është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, ka pranuar në tërësi përfundimin e shkallës së parë për themelësinë e kërkesëpadisë, ngase edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë në këtë çështje juridike kontestuese. Në këtë kontekst nuk janë pranuar pretendimet ankimore për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, pasi që nga gjendja faktike e konstatuar e cila është kualifikuar në përputhje me të drejtën materiale, ka rezultuar se kërkesëpadia e paditësit është e pathemeltë.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 dhe 201 par.1 pika (d) të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.3857/21, datë 23.05.2024

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari
Arsim Hamzaj